REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 543/26 Dt. 18.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, të Rregullores (QRK) nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore për Komunën e Prizrenit, për periudhën 2027-2029. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

   1.1. Fatmir Memaj.....drejtor i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
   1.2. Kumrije Bytyqi.....drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale,
   1.3. Muhamed Shala,.....udhëheqës i Shërbimeve Sociale,
   1.4. Bashkim Rakaj,.....udhëheqës i DPMD-së,
   1.5. Atila Arzuallxhiu,..... .....përfaqësuese nga Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës,
   1.6. Emine Gashi..... udhëheqëse e Sektorit për Barazi Gjinore,
   1.7. Jubilea Kabashi.....përfaqësuese nga Strehimorja,
   1.8. Tringa Kasëmi.....përfaqësuese nga OJQ-të në nivelin lokal aktive në të drejtat të njeriut/grave,
   1.9. Lulëzim Sulejmani,.....përfaqësues nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave,
   1.10. Fadil Bajraktari.....drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare,
   1.11. Šemsa Sagdati...mbrojtëse e viktimave nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave,
   1.12. Fjorda Mujolar.....përfaqësuese nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas,
   1.13. Derya Kala,.....përfaqësuese nga Zyra për Komunitete dhe Kthim,
   1.14. Selajdin Cena,.....përfaqësues nga OSBE-ja, anëtar.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Planin e Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore për Komunën e Prizrenit, për periudhën 2027-2029, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të draftit përkatës, të njëjtat ti procedohen organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.

3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.